



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 307, Datë 30.11.2022

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “HYDROPOWER” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI “FOTOVOLTAIK” ME
KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW, ME VENDNDODHJE QARKU FIER**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1 gërma “a”, nenit 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE, nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 30.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1999/3 prot., datë 23.11.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “HYDROPOWER” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në Povelcë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier, për një afat 25 vjeçar”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 263, datë 14.10.2022 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “HYDROPOWER” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 MW, për një afat 25-vjeçar.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 15.10.2022 dhe 17.10.2022) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 24.10.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.
- Me vendimin nr. 291, datë 10.11.2022, bordi i ERE-s vendosi të zgjasë me 20 (njëzetë) ditë afatin e vendimmarrjes së tij mbi aplikimin e shoqërisë “HYDROPOWER” sh.p.k. duke i lënë

shoqërisë detyrimin që brenda 10 (dhjetë) ditëve të depozitohet në ERE dokumentacionin e plotë mbi aftësinë financiare për të zhvilluar projektin fotovoltaike, referuar vlerës së investimit të tij.

- ERE njoftoi shoqërinë për vendimmarrjen e mësipërme me shkresën nr. 1747/6 prot., datë 17.11.2022, shoqëria ka kthyer përgjigje me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1747/7 prot., datë 18.11.2022, duke depozituar dokumentacionin e kërkuar.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitohet në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); Shtojcën 1, Shtojcën 1A dhe Shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (Aneksi A).
- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “HYDROPOWER” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar. Aplikuesi ka derdhur për llogari të ERE-s një shumë më të madhe sesa pagesa e aplikimit e përcaktuar në Aneksin A, të rregullores së licencimit, ndaj në të tilla rrethana, pagesa shtesë do t’i kthehet.
- Shoqëria ka parashikuar që data e fillimit të operimit të centralit do të jetë 24.12.2023. Në këto rrethana dhe në kuadër të mbikëqyrjes, vlerësohet që t’i kërkohet shoqërisë që të depozitohet në ERE informacion mbi ecurinë e investimit jo më vonë se 3 (tre) muaj përpara datës së parashikuar të fillimit të operimit, pra brenda datës 24.09.2023.
- Duke iu referuar deklaratës së vetë shoqërisë se ajo do të fillojë punimet në vitin 2023, vlerësohet që në kuadër të mbikëqyrjes, t’i kërkohet shoqërisë që të depozitohet në ERE informacion mbi fillimin e punimeve për ndërtimin e veprës jo më vonë se 2 (dy) muaj nga data që shoqëria ka parashikuar fillimin e operimit, brenda datës 24.10.2023.
- ERE, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke vlerësuar sa deklaruar nga shoqëria dhe dokumentacionin teknik rezulton se jetëgjatësia e pritshme e centralit është 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “HYDROPOWER” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje Qarku Fier, për një afat 25-vjeçar.
2. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

